



STATUTI

i

Association of Paraplegic and Children Paralysis Persons of Kosovo

Ky statut do të qeverisë shoqatën jofitimprurëse, Association of Paraplegic and Children Paralysis Persons of Kosovo, e themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Neni 1

Emri, forma, adresa dhe simboli

1. Organizata quhet: Association of Paraplegic and Children Paralysis Persons of Kosovo.
2. Ajo njihet me akronimin: HANDIKOS.
3. Në vijim të këtij statuti dhe për aq sa është e aplikueshme, shoqata do të përdor akronimin HANDIKOS.
4. HANDIKOS është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në dispozitat e Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
5. HANDIKOS nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e HANDIKOS do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të shoqatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për asnjërin nga themeluesit, ndonjë anëtar të shoqatës, drejtorin, bordin, ndonjë të punësuar apo donator të shoqatës. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona bëjnë për shoqatën.
6. HANDIKOS nuk do të hyjë në marrëdhënie kontraktuale, përveç atyre nga marrëdhënia e punës, me ndonjë organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet HANDIKOS dhe anëtarëve, drejtorit, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj ndalohet, përveç, nëse Kuvendi i Anëtarëve vendos, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për shoqatën, dhe se shoqata nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.
7. HANDIKOS mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me paragrafin 1.4 të këtij Statuti dhe nenin 4 të Ligjit për Lirim të Asociimit në OJQ 04/L-57, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të

aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.

8. HANDIKOS e ka zyrën e saj qendrore në Veternik, Rr. Nekibe Kelmendi, 10000 Prishtinë, Kosovë. Ndërsa për nevoja të veta HANDIKOS mund të ketë zyre edhe nëpër lokalitete tjera të Kosovës, për ti zhvilluar aktivitetet e saj me qëllim të arritjes së qëllimit dhe objektivave të saj.

9. HANDIKOS ka simbolin i cili miratohet dhe mund të ndryshohet nga Kuvendi i Anëtarëve, dhe përmban: në anën e majtë hartën e Kosovës me ngjyrë të kaltër të ndarë me vija bardhë dhe kaltër, në mes të hartës simbolin ndërkombëtar të karrocës së personave me aftësi të kufizuara me ngjyrë të bardhë dhe në anën e djathtë përmban akronimin HANDIKOS me ngjyrë të kaltër dhe në përfundim akronimit përmban fjalët: SHOQATA E PARAPLEGJIKËVE DHE E PARALIZËS SË FËMIJË TË KOSOVËS dhe ASSOCIATION OF PARAPLEGICS AND PARALYSED CHILDREN OF KOSOVO me ngjyrë të kaltër.

Neni 2 Themeluesit

HANDIKOS është themeluar në vitin 1983, ndërsa është ri regjistruar në vitin 2000, pranë institucionit kompetent për regjistrim të organizatave joqeveritare në Kosovë nga z. Halit Ferizi, z. Xhelal Xharra dhe z. Afrim Maliqi.

Neni 3 Qëllimi

1. HANDIKOS ka për qëllim përfaqësimin dhe përkrahjen e personave me aftësi të kufizuara duke avokuar dhe lobuar, duke ofruar shërbime profesionale për të ngritur mirëqenien e tyre dhe për të arritur të drejta të barabarta, një jetë të pavarur dhe të dinjitetshme për të gjithë.

2. Për ta përmbushur qëllimin e saj, HANDIKOS cakton, por nuk do të kufizohet vetëm në këto objektiva:

- a) Mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara, ku përfshihen e drejta për lëvizje të lirë, shërbime cilësore shëndetësore, mirëqenie sociale, arsim dhe punësim.
- b) Ofrimi i shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara fizike.

3. Për ti arritur objektivat e saj, HANDIKOS do të ndërmerr, por nuk do të kufizohet vetëm në këto aktivitete:

- a) Pjesëmarrje aktive avokuese dhe lobuese tek institucionet publike dhe jo publike, vendore dhe ndërkombëtare, për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe pozitës së personave me aftësi të kufizuara fizike në shoqëri;
- b) Në bazë të përvojës dhe ekspertizës, ofron rekomandime për përfshirjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara fizike në politikat dhe legjislacionin e Kosovës.

- c) Ndërmerr fushata për ndërgjegjësimin e shoqërisë për t'i njohur, kuptuar, pranuar dhe respektuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara fizike.
- d) Ofron shërbime sociale për personat me aftësi të kufizuara, në bazë të standardeve të shërbimeve dhe me staf të kualifikuar profesional dhe të licencuar për shërbime sociale dhe shërbime tjera profesionale.

4. HANDIKOS në bazë të nevojave të personave me aftësi të kufizuara fizike, do të hartojë strategjitë, të caktoj programet, aktivitetet dhe prioritetet e veprimtarisë së saj për të arritur qëllimin dhe realizuar objektivat. Strategjitë përgatiten dhe propozohen nga grupet punuese të udhëhequra nga Drejtori dhe Bordi, ndërsa miratohen nga Kuvendi i Anëtarëve.

Neni 4 **Anëtarësimi**

1. Anëtarësimi në HANDIKOS është i hapur për çdo person me aftësi të kufizuara fizike, pavarësisht prej racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar fizike ose ndonjë statusi tjetër personal. Për t'u anëtarësuar në shoqatë, secili i person me aftësi të kufizuara fizike i interesuar duhet të pranohet Statutin, Qëllimin dhe Objektivat e shoqatës dhe të angazhohet për përmbushjen e tyre.

1.1. Me rregullore të veçantë të miratuar nga Kuvendi i Anëtarëve, do të caktohen kriteret për regjistrimin e anëtarëve.

2. Kuvendi i anëtarëve do të vendos nëse do të kërkohet pagesa e anëtarësimit nga anëtarët. Në rast të vendosjes së pagesës së anëtarësimit, Kuvendi i Anëtarëve do të vendosë për shumën, rregullat dhe procedurat e pagesës së anëtarësimit, përfshirë marrjen e masave të ndryshme, deri në përjashtimin e anëtarit nga organizata në rast të mos-pagesës së anëtarësisë.

3. Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve edhe në këto raste:

- a) shkeljes së statutit;
- b) mungesës së pa-arsyeshme për dy herë radhazi në mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve;
- c) përhapjes së propagandës së rreme dhe të dëmshme kundër HANDIKOS;
- d) veprimeve kundër qëllimit dhe objektive të shoqatës;
- e) veprimeve diskriminuese dhe ofenduese kundër anëtarëve;

4. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet me vendim të Kuvendit të Anëtarëve, bazuar në Rregulloren përkatëse për të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve.

5. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me shumicë të anëtarëve prezent.

Neni 5

Kuvendi i Anëtarëve

1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i shoqatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të shoqatës.
2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të shoqatës. Në këtë kuadër, Kuvendi i Anëtarëve ka kompetencë të zgjedhë dhe të shkarkojë Drejtorin, anëtarët e Bordit, të aprovojë raportet periodike dhe vjetore financiare dhe të punës, të interpretojë dhe ndryshojë Statutin, si dhe të vendosë për bashkimin, ndarjen apo shuarjen e shoqatës dhe të ndryshoj simbolin e shoqatës. Këto përgjegjësi nuk mund të delegohen në organet tjera ekzekutive apo këshillëdhënëse.
3. Përpos përgjegjësive të rezervuara që ka, Kuvendi i Anëtarëve gjithashtu ka edhe këto përgjegjësi: të vendosë për pasurinë e shoqatës, të aprovojë Rregulloren e punës së Kuvendit të Anëtarëve dhe rregulloret tjera të nevojshme për shoqatën, miraton Strategjitë dhe programet vjetore për aktivitetet e nevojshme për arritjen e qëllimit dhe përmbushjen e objektivave të shoqatës.
4. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij te Drejtori, Bordi, zyrtarët tjerë ekzekutiv dhe këshillëdhënës, ose edhe te të punësuarit e shoqatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij, me përjashtim të përgjegjësive të cilat nuk delegohen sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe paragrafit 2 dhe 3 të Nenit 5 të këtij Statuti.
5. Me rregulloren e Punës së Kuvendit të Anëtarëve do të caktohen dhe specifikohen rregullat, procedurat dhe mënyra e punës së Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 6

Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve

1. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.
 - 1.1. Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore duhet të mbahen jo më herët se muaji dhjetor i viti raportues dhe jo më vonë se muaji shkurt i vitit pasues.
2. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve ose Drejtori apo shumica e anëtarëve të Bordit. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit të Anëtarëve i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, Drejtorin, Bordin dhe sipas nevojë edhe zyrtarët e tjerë ekzekutiv, në pajtim me procedurat e përcaktuara në paragrafin vijues.

3. Lajmërimi me shkrim për Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore dhe/ose Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për mbledhjen do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve, Drejtorit, Bordit dhe sipas nevojë kur janë të ftuar edhe zyrtarëve tjerë ekzekutiv, së paku shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

4. Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së anëtarëve. Nëse ky kuorum nuk arrihet në tentimin e parë, takimi do të shtyhet për një ditë të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve dhe të ftuarve tjerë.

5. Secili anëtar i shoqatës e ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.

6. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent, nëse me ndonjë dispozitë tjetër të statutit nuk është përcaktuar ndryshe.

7. Asnjë anëtar i Kuvendit të Anëtarëve nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i Kuvendit të Anëtarëve konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

8. Në mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve kur zgjidhet Drejtori apo anëtarët e Bordit, Kuvendi i Anëtarëve në fillim të mbledhjes, me propozim të Kryesuesit, i zgjedhë edhe dy anëtarë të kryesisë së Kuvendit të Anëtarëve.

8.1. Kryesinë e tillë e udhëheq Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve.

9. Kryesuesin e Kuvendit të Anëtarëve e zgjedhë Kuvendi i Anëtarëve nga radhët e veta, me shumicën e votave të anëtarëve prezent, me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhje.

10. Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve ka përgjegjësi të thirrjes së Mbledhjeve të Kuvendit, t'i kryesoj ato, të kujdeset për mbarëvajtjen e Mbledhjeve, të nënshkruaj vendimet dhe aktet tjera që i nxjerrë Kuvendi për të cilat nuk autorizohet Drejtori dhe të nënshkruaj vendimin dhe kontratën e punës së Drejtorit.

Neni 7 Drejtori

1. Drejtori është udhëheq i ekzekutivit të shoqatës, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e dhëna me këtë Statut, Rregullore tjera të shoqatës dhe autorizimeve shtesë të dhëna nga Kuvendi i Anëtarëve.

2. Drejtori është njëherit edhe përfaqësues i autorizuar i shoqatës dhe gjithmonë duhet të veprojë në pajtim me këtë Statut, Rregullore tjera të shoqatës, Vendimet e Kuvendit të Anëtarëve dhe ligjeve në fuqi.

3. Drejtori zgjedhet nga Kuvendi i Anëtarëve nga radhët e anëtarëve, me shumicë të votave të anëtarëve, me mandat katër (4) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

4. Përgjegjësitë e Drejtorit janë:

4.1. Drejtori, si përfaqësues i autorizuar i shoqatës është përgjegjës para ligjeve dhe institucioneve shtetërore për veprimet dhe mos-veprimet e tij si përfaqësues i autorizuar.

4.2. Si përfaqësues i autorizuar i shoqatës, Drejtori është përgjegjës për kryerjen e obligimeve pranë institucioneve shtetërore për përgjegjësitë ligjore dhe kontraktuale të shoqatës;

4.3. Drejtori respekton dhe zbaton Statutin, Strategjitë, Planet Vjetore dhe Vendimet dhe Autorizimet e Kuvendit të Anëtarëve;

4.4. Me autorizim të Kuvendit të Anëtarëve, Drejtori e përfaqëson shoqatën në aktivitetet avokuese dhe lobuese, në media, në organizata dhe institucione vendore dhe ndërkombëtare;

4.5. Pas miratimit të Strategjisë dhe Planeve Vjetore nga Kuvendi i Anëtarëve, Drejtori i nënshkruan propozim-projektet dhe marrëveshjet për implementim e tyre, si dhe memorandumet me palët e treta;

4.6. Pas miratimit nga Kuvendit i Anëtarëve të Planeve Vjetore, Drejtori i nënshkruan kontratat e të punësuarve në shoqatë dhe kontratat e tjera për shoqatën;

4.7. Drejtori prezanton raportet e rregullta vjetore financiare dhe të punës të shoqatës për aprovim;

4.8. Drejtori është përgjegjës për monitorimin dhe mbarëvajtjen e implemtimit të projekteve, duke përfshirë edhe mbarëvajtjen e raportimeve tek donatorët për projektet e financuara nga donatorët.

4.9. Drejtori mund të emëroj zyrtarë tjerë ekzekutiv, si staf mbështetës të Drejtorit në përputhje me Planet Vjetore buxhetore dhe Planet e Punës.

5. Drejtori i përgjigjet dhe i raporton Kuvendit të Anëtarëve.

6. Drejtori paguhet vetëm për punën që e bën për shoqatën dhe atë në përputhje me Planet Vjetore Buxhetore dhe Planet e Punës të miratuara nga Kuvendi i Anëtarëve.

7. Mandati i Drejtorit pushon:

7.1. Në rast të vdekjes;

7.2. Dorëheqjes, ose

7.3. Shkarkimit nga Kuvendi i Anëtarëve, në rastet kur nuk zbaton paragrafin 4 të këtij neni.

8. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të Drejtorit, Kuvendi i Anëtarëve zgjedh Drejtorin me mandat të ri.

9. Në rastet kur nuk mund të zgjedhet Drejtori, Kuvendi i Anëtarëve zgjedh një Ushtrues Detyre të Drejtorit me mandat jo më shumë se gjashtë (6) muaj.

Neni 8 **Bordi**

1. Bordi është organ këshillëdhënës.

2. Bordi jep këshilla të ndryshme për Drejtorin dhe Kuvendin e Anëtarëve, për të drejtat dhe përgjegjësitë e organeve të shoqatës, për çështjet e përgjegjësive financiare të shoqatës, për çështjet e bashkëpunimit dhe partneritet të shoqatës me institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare, për çështjet e planeve financiare dhe të punës, për çështjet e raportimeve të shoqatës tek donatorët dhe institucionet vendore, për çështjet e hartimit dhe implementimit të projekteve dhe për ndonjë çështje tjetër që i kërkohet nga Kuvendi i Anëtarëve apo Drejtori.

3. Bordi i ofron këshilla Drejtorit dhe zyrtarëve tjerë ekzekutiv në lidhje me zbatimin e Statutit, Planeve, Strategjive dhe projekteve, për zbatimin e Rregullores Financiare dhe Rregulloreve tjera të shoqatës.

4. Kur Bordi e vlerëson të nevojshme, mund të rekomandon Mbledhje të Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Kuvendit të Anëtarëve për të shqyrtuar çështjet me interes.

5. Bordi i ka tre (3) anëtarë me përbërje nga personat që janë dhe që nuk janë anëtarë të Kuvendit të Anëtarëve.

5.1. Bordi zgjedhet nga Kuvendi i Anëtarëve, me mandat pesë (5) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

5.2. Anëtarët e Bordit zgjedhen individualisht me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm.

5.3. Kryesuesi i Bordit zgjedhet nga anëtarët e Bordit.

6. Anëtarët e Bordit mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me shumicë votash të anëtarëve prezent të Kuvendit të Anëtarët.

7. Mandati i anëtarit të Bordit pushon edhe:

8.1. Në rast të vdekjes;

8.2. Dorëheqjes ose

8.3. Krijimit të konfliktit të interesit.

8. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të ndonjë anëtari të Bordit, Kuvendi i Anëtarëve zgjedh anëtar të ri të Bordit për kohën e mbetur të mandatit të anëtarëve tjerë të Bordit.

9. Asnjë pagesë ose kompensim nuk duhet t'u bëhet anëtarëve të Bordit pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve, përveç në rastet kur kryejnë ndonjë punë të caktuar për organizatën.

10. Asnjë anëtar i Bordit nuk i lejohe të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i Bordit konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

Neni 9

Zyrtarët dhe Nëpunësit

1. Drejtori mund të emëroj zyrtarë tjerë ekzekutiv, si staf mbështetës të Drejtorit në përputhje me Planet Vjetore buxhetore dhe Planet e Punës.

2. Në rast nevojë shoqata punëson edhe persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të shoqatës.

3. Së bashku me Planin Vjetor Buxhetor dhe të Punës, për të implementuar projektet dhe për të kryer punët e ndryshme në shoqatë, Kuvendi i Anëtarëve aprovon edhe punësimin e stafit të nevojshëm.

4. Zyrtarët dhe nëpunësit duhet të punësohen në përputhje me Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës.

5. Të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen Zyrtarëve dhe Nëpunësve, si dhe obligimet dhe përkrahjet e punës dhe përgjegjësitë e tyre duhet të jenë në bazë ligjit, këtij Statuti, Rregullore së brendshme për marrëdhëniet e punës në shoqatë dhe Planeve Vjetore Buxhetore.

6. Të gjitha pagesat e zyrtarëve dhe nëpunësve duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer për shoqatën.

7. Drejtori është zyrtari kryesor dhe mbikëqyrës i të punësuarve si dhe i nënshkruan kontratat e zyrtarëve dhe nëpunësve.

Neni 10

Shpërbërja e organizatës

1. Shoqata mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve.

2. Kur të vendos për shpërbërjen e shoqatës, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës, fondacionit apo ndonjë OJQ-je në Kosovë që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jenë paguar borxhet e shoqatës. Shoqata(t), fondacioni(et) apo OJQ-ja (OJQ-të) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njëjta ose të ngjashme sikurse HANDIKOS.

Neni 11
Ndryshimet e statutit

1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e shumicës së anëtarëve prezentë të Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 12
Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar

1. Drejtori, Bordi dhe Zyrtarët e tjerë ekzekutiv të emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve në Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore ose kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Anëtarëve në Mbledhje të Përgjithshme të Jashtëzakonshme.

2. Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

Aprovuar në Prishtinë, me datë 09.09.2016

Nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar

Afrim Maliqi



Përfaqësues i autorizuar/Drejtor

